

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)G*

EGIAN MED

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L71715003C

NUIS/NIPT

Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4

Adresa

Tiranë

Albania

1023

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0693580526

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

egianmed@gmail.com

E-mail

administratori Fatos Lashi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2022/11/08

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0693580526

069358052

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-48360-11-02-2022

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

3232130

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

“Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2022/11/14

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

*(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)G*

---

Data e nënshkrimit të kontratës

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)G*

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2022/11/14

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/41304/11022022

90922000-690923000-3

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

*(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)G*

Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 628/2022, datë 04.07.2022; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr 637/2022, Datë 06.07.2022, etj

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrateG

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

### 3. Rrethanat dhe faktet □

*Përshkruani rrethanat e faktit. Ĝ*

Më datë 03/11/2022, në sistemin elektronik të prokurimeve (app.gov.al) të Agjencisë së Prokurimit Publik, është publikuar nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara procedura e prokurimit: “Procedure e hapur e thjeshtuar” Me numër reference të procedurës: REF-48360-11-02-2022me objekt: “Shërbim Dezinfektimi Deratizim Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh”

? Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 5 (formulari i specifikimeve teknike) të DT, tek rubrika (Skicimet, parametrat teknik etj) është kërkuar:  
Preparat për dezinfektim. Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jenë komponime të amonit kuaternar: Benzyl-C12-16-alkyldimethyl chlorides (CAS no.68424-85-1) 15%-30%, Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS,no.7173-51-5) 5%-15%, Glutaradehyde (CAS no.111-30-8) 5%-15%, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit). Destinacioni i përdorimit: Në ambiente të brendshme, të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshte, rrugë, sheshe publike, holle të hapura, sheshe pushimi, ambiente pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Preparat për dezinfektim. Insekticid për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra etj.). Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Deltamethrinë (CAS no.52918-63-5) në përqendrim 2.5% - 3%. Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml – 1 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Preparat për dezinfektim në ambiente sensitive. Insekticid natyral për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambiente sensitive (kuzhina, mensa etj.). Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Pyrethrin (CAS no.8003-37-7) ose Pyrethrum (CAS no.89997-63-7) në përqendrim 2.5% -3.5% dhe Piperonyl butoxide (CAS no. 51-03-6) në përqendrim 10%-15% si sinergjist për rritjen e efektivitetit të preparatit. Paketimi: Paketimi: Në konfeksion plastik 100,ml - 1 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Preparat për luftimin e furrtaeve. Insekticid për luftimin e insekteve në formë xheli. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidacloprid (CAS no.138261-41-3) në përqendrim 2%-2.5%. Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe 10g-30g. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

Preparat për luftimin e minjve. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbyllura. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabite ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë Coumatetralyl (CAS no. 5836-29-3) me përqendrim 0.03%-0.04%. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t'i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (denatonium benzoate, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për

këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg-5kg i ndarë në copa nga 10-15g secila.

Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit.

? Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 2, është kërkuar: “Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punësuar staf si me poshte:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik. Për drejtuesin teknik te paraqitet:
  - Diplomë me profesion Shëndet Publik /Biologji/Kimi.
  - Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqerore individuale të leshuar nga e - albania.
  - Kontrate pune perkatase.
  - Librezë pune.
  - Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise të paraqes deklarate perkatase.

b) Minimalisht 2 (dy) persona, sipas profileve të mëposhtme:

- specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;
- .....
- Për punonjesit e përcaktuar në pikën b) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune.

? Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 5 është kërkuar: “Operatorët ekonomike me anë të një deklarate, duhet të marrin përsipër, se me nënshkrimin e kontrates, duhet të paraqes për çdo produkt, raport-testimet si dhe certifikimet perkatase, të cilat duhet të jenë sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike të AK, të leshuara nga organet kompetente të akredituara.”

? Në dokumentat e tenderit në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 7 është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se, produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, janë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”

#### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Pretendojmë se, kriteret dhe kushtet e përcaktuara më sipër, nuk janë vendosur në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës me Nenin 77(Kërkesat për kualifikim) të ligjit Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; me VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe me vendime të KPP të dhëna në raste të ngjashme me palë autoritetin tuaj kontraktor (Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 628/2022, datë 04.07.2022) apo vendime të tjera të KPP-se të dhëna për raste të ngjashme.

Konkretisht, argumentojmë si më poshtë vijon:

1- Në lidhje me: “...PREPARAT PËR DEZINFEKTIM. Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktëreve, kërpudhave, mykut etj. Lënda bazë aktive e këtij preparati

duhet të jenë komponime të amonit kuartërnar: Benzyl-C12-16-alkyldimethyl chlorides (CAS no.68424-85-1) 15%-30%, Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS,no.7173-51-5) 5%-15%, Glutaradehyde (CAS no.111-30-8) 5%-15%, dhe përbërës të tjerë të shtuar sipas produktit). Destinacioni i përdorimit: Në ambjentë të brendshme, të jashtme si zyra, qendra sociale, shkolla, kopshtë, rrugë, sheshe publike, holle të hapura, sheshe pushimi, ambientë pritje jashtë, rrugica hyrëse-dalëse, mure të jashtme godine, mure rrethuese, etj. Paketimi: në konfeksion plastik 1 deri 5 litra dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit...”, i kundërshtojmë specifikimet teknike të mësipërme me argumentat si vijon:

Në lidhje me vendosjen e kriterit të përcaktimit të lëndës aktive ose lëndëve aktive në përberje të produktit biocid për përdorim në shëndet publik, AK ka përdorur një kriter diskriminues, abuziv dhe të paracaktuar në lidhje me emrin e një produkti biocid të caktuar. Kjo mbeshtëtet në faktin se vec njëres prej lëndëve aktive në përberje të produktit biocid të përcaktuar, janë vendosur edhe disa lëndë të tjera aktive me përberje në %, që përkojnë vetëm me një PRODUKT BIOCID, dezinfektant që është produkti me emrin tregëtar “VIROCIDI”.

Ne këto kushte po ju parashtrojmë dy fakte që duhet të pranohen dhe të ndryshohen për mirëfunksionimin e punës dhe të transparencës dhe konkurrencës së hapur dhe të ndershme:

SE PARI: Nëse përqëndrimi i secilës prej lëndëve aktive në përberje të këtij produkti biocid, që ju kërkoni për dezinfektim, janë vendosur përqëndrime fikse dhe të paracaktuara ashtu sic janë në përberje të një produkti të vetëm biocid, pra nuk ka një diapazon të gjerë që përkon me minimumin dhe maksimumin e lejimit të përqëndrimit të një lëndë aktive në % në përberje të një produkti biocid dezinfektant, ashtu sic përcaktohet nga rregullat e BE dhe të raporteve të vleresimit të secilës lëndë aktive në sistemin e ECHA-s. Atëherë çfarë ndryshimi ka nëse një produkt që e ofrojmë në të ketë përqëndrimin jo me diapazonet që keni caktuar ju por, me diapazon me të gjere %, si psh nëse Benzyl-C12-16-alkyldimethyl chlorides (CAS no.68424-85-1) 15%-30%, po nëse në e ofrojmë këtë përqëndrim në diapazonin 14.9% -30.1%, ose me të madh? Çfare kriteri do perdorni ju per të na skualifikuar, kur edhe përqëndrimi i caktuar nga ne, është i përdorshëm dhe i lejuar në fushën e shëndetit publik për këtë lëndë aktive? Gjithashtu, e njëjta gje thuhet për lëndët e dytë aktive Didecyldimethyl Ammonium Chloride (CAS,no.7173-51-5) 5%-15%, po nëse në e ofrojmë me diapazon përqëndrimi 4.9% - 15.1? Po për lëndën e tretë aktive Glutaradehyde (CAS no.111-30-8) 5%-15%, po nëse në e ofrojmë në përberje me 4.9% - 15.1%?

SË DYTI: Përberja e lëndëve aktive të kërkua nga ju për këtë produkt, nuk përkojnë me një produkt biocid për përdorim në shëndet publik, por për shërbimet veterinarë, që janë shumë herë më të ndryshme sesa lëndët që perdoren në fushën e shëndetit publik. Kanë lëndë të ndryshme në përberje dhe % të ndryshme, duke mos patur % shumë të larta ic kanë produktet e shërbimit veterinar dhe ato të mbrojtjes së bimeve, ku % i lëndëve aktive është disa herë me i lartë sesa % i tyre në produktët biocid në përdorim në shëndet publik. Ju lutemi, mos vendosni kriteret për produktet e shërbimit veterinar, në një tender që kërkohet të kryhet vetëm në zona apo vende që mbulohen vetëm nga shëndeti publik, sepse do shkaktoni kaos dhe ndonjë shperthim të mundshëm helmimesh ose alergjish.

SE TRETË: Kërkesa për dezinfektim të ambienteve publike nuk mund të kufizohet vetëm me një kërkesë kaq të ceket të lëndëve aktive të përcaktuara mirë dhe me diapazone % të tyre vetëm në përberje të një lloji produkti biocid, gjë e cila e kanalizon tenderin në një lëndë të vetme dhe në tej në situata monopoli, gjë e cila na lejon të dyshojmë se tenderi është paracaktuar.

Vendosja e kriterëve të tilla është e pabazuar në ligj dhe rregulloren e BE dhe ECHA; tek të cilat lëndët aktive në përdorim në fushën e shëndetit publik, nuk kanë vetëm një përqëndrim dhe

diapazon të caktuar të % sic e kërkonte ju, por përqëndrimi i lëndë aktive në përbërje të produktit biocid lejohet të perdoret në një diapazon të këtij përqëndrimi që nuk është vetëm sa e specifikoni ju, por që përfshihen edhe vlera të tjera të përqëndrimit të lëndës aktive në përbërje të produktit biocid dhe akoma më shumë lëndë aktive të tjera që shërbejnë si dezinfektantë.

Në keto kushte sugjerojmë që njësia juaj të konsultohet me databasen e ECHA për lëndët aktive dhe me raportet e vlerësimit të ketyre lëndëve ne ECHA ose Assessment Report. Njësia duhet të lërë një diapazon ose interval përqëndrimi nga një vlerë minimale e lejuar në një vlerë maksimale të lejuar në përputhje me vlerësimet e bëra në ECHA për këtë lëndë aktive.

Nëse njësia juaj cakton vetëm këto lëndë aktive, edhe kjo nuk është e argumentuar sepse mund të vërë një gamë me të gjerë lëndësh aktive për produktet biocide për përdorim në shëndetin publik ose kombinim të dy, tre ose më shumë lëndësh aktive në një produkt biocid.

Caktimi i përqëndrimit në (%) të lëndëve aktive dhe i vetë numrit të lëndëve aktive, e drejton tenderin vetëm tek një number i vetëm produktësh biocide, e vetëm në një kompani prodhuese ne botë, duke e bere situatën monopol, pasi kompani të tjera përdorin % të lëndëve aktive me përbërje dhe (%) të ndryshme, etj.

2- Në lidhje me: "...PREPARAT PËR DEZINSEKTIM. Insekticid për luftimin e insektëve fluturuese dhe zvarritëse (milingona, miza, pleshta, rriqna, morra etj.). Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Deltamethrinë (CAS no.52918-63-5) në përqëndrim 2.5% - 3%. Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Paketimi: Në konfeksion plastik 100 ml – 1 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. ...", i kundërshtojmë specifikimet teknike të mësipërme me argumentat si vijon:

Vendosja e kriterit të përcaktimit të lëndës aktive për produktin biocid ne përdorim në shendet publik, nga ana e autoritetit tuaj kontraktor është diskriminuese, abuzive dhe për më tepër me efekt kufizues pasi përcakton emrin e një produkti biocid të caktuar. Kjo mbeshtetet në faktin se vec të VETMES lëndë aktive të kërkuar, është kërkuar dhe përcaktuar edhe vlera fikse e përqëndrimit të kesaj lëndë aktive. Nëse përqëndrimi kërkohet 2.5-3% Deltametrine, atëhere cfarë ndryshimi ka nëse një produkt që e ofron kompania jonë ka përqëndrimin 2.49% ose 3.1% Deltametrinë? Vendosja e një kriteri të tillë është e pabazuar në ligj dhe rregulloren e BE dhe ECHA; tek të cilat Deltametrina në përdorim në fushën e shëndetit publik, nuk ka vetëm një përqëndrim të caktuar sic e keni kërkuar ju në vlerën prej 2.5-3%, por përqëndrimi i Deltametrinës si lëndë aktive në përbërje të produktit biocid lejohet të perdoret në një diapazon të këtij përqëndrimi që nuk është vetëm 2.5-3% por që përfshihen edhe vlera të tjera të përqëndrimit të lëndës aktive në përbërje të produktit biocid. Në keto kushte sugjerojmë që njësia juaj të konsultohet me databasen e ECHA për lëndët aktive si deltametrina dhe me raportet e vlerësimit të kesaj lëndë ne ECHA ose Assessment Report. Një raport të tillë e keni edhe bashkëngjitur dhe kërkojmë ndryshimin e kriterit të caktimit të një vlere fikse 2.5-3% të përqëndrimit të Deltametrinës në produktin biocid. Njësia duhet të lërë një diapazon ose interval përqëndrimi nga një vlere minimale e lejuar ne një vlere maksimale të lejuar në përputhje me vlerësimet e bëra ne ECHA për këtë lëndë aktive.

Njësia juaj ka përcaktuar vetëm një lëndë aktive, edhe kjo nuk është e argumentuar pasi mund të vërë një game me të gjerë lëndësh aktive për produktet biocide për përdorim në shendetin publik ose kombinim të dy, tre ose më shumë lëndësh aktive në një produkt biocid.

Caktimi i përqëndrimit 2.5-3% të Deltametrinës, e drejton tenderin vetëm tek një numër i kufizuar produktësh biocide, që ne disa rastë mund të jetë edhe vetëm një kompani prodhuese ne botë, duke e bere situatën monopol. Sepse kompani të tjera perdorin % të Deltametrines 2%, 4%, 6%,

1.5% etj.

3- Në lidhje me:...”Preparat për dezinfektim në ambiente sensitive. Insekticid natyral për luftimin e insekteve fluturuese dhe zvarritëse në ambiente sensitive (kuzhina, mensa etj.). Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Pyrethrin (CAS no.8003-37-7) ose Pyrethrum (CAS no.89997-63-7) në përqëndrim 2.5% -3.5% dhe Piperonyl butoxide (CAS no. 51-03-6) në përqëndrim 10%-15% si sinergjist për rritjen e efektivitetit të preparatit. Paketimi: Paketimi: Në konfeksion plastik 100,ml - 1 lt. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. ...”, i kundërshtojmë specifikimet teknike të mësipërme me argumentat si vijon:  
Ne lidhje me vendosjen e kriterit të përcaktimit të lëndës aktive për produktin biocid në përdorim në shëndet publik, AK ka përdorur një kriter diskriminues, abuziv dhe me efekt kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë të interesuar, pasi ka përcaktuar emrin e një produkti biocid të caktuar. Kjo mbështetet në faktin se, vetë lëndës aktive kryesore të kërkuar, është kërkuar dhe përcaktuar edhe vlera fikse e përqëndrimit të kësaj lëndë aktive. Nëse përqëndrimi kërkohej 2.5-3.5% Pyrethrin, atëherë çfarë ndryshimi ka nëse një produkt që e ofron kompania jonë ka përqëndrimin 2.49% ose 3.6% Pyrethrins? Vendosja e një kriteri të tillë është e pabazuar në ligj dhe rregulloren e BE dhe ECHA; tek të cilat Pyrethrins në përdorim në fushën e shëndetit publik, nuk ka vetëm një përqëndrim të caktuar prej 2.5-3% sic e kerkoni ju, por përqëndrimi i Pyrethrins si lëndë aktive në përbërje të produktit biocid, lejohet të përdoret në një diapazon të këtij përqëndrimi që nuk është vetëm 2.5-3.5% por që përfshihen edhe vlera të tjera të përqëndrimit të lëndës aktive në përbërje të produktit biocid. Në keto kushte sugjerojmë që njësia juaj të konsultohet me databasën e ECHA për lëndët aktive si Pyrethrins dhe me raportet e vlerësimit të kësaj lëndë në ECHA ose Assessment Report.

Kërkojmë ndryshimin e kriterit të caktimit të një vlere fikse 2.5-3.5% të përqëndrimit të Pyrethrins në produktin biocid. Njësia duhet të lëre një diapazon ose interval përqëndrimi nga një vlere minimale e lejuar në një vlerë maksimale të lejuar në përputhje me vlerësimet e bera në ECHA për këtë lëndë aktive.

Njësia juaj ka përcaktuar vetëm një lëndë aktive, edhe kjo nuk është e argumentuar sepse, duhet të vendosë një game më të gjere lëndësh aktive për produktet biocide për përdorim në shëndetin publik ose kombinim të dy, tre ose me shume lëndësh aktive në një produkt biocid.

Përcaktimi i përqëndrimit 2.5-3.5% të Pyrethrins, e drejton tenderin vetëm tek një numër i kufizuar produktësh biocide, që në disa raste mund të jetë edhe vetëm një kompani prodhuese në botë, duke e bërë situatën monopol. Sepse kompani të tjera përdorin % të Pyrethrins 2%, 4%, 6%, 1.5% etj.

Edhe për përberesin aktiv dytësor sic është Piperonyl Butoksid, qëndron i njëjti argumentim!

Në keto kushte rrjedhimisht mendojmë se, përmbajtja e lëndëve aktive në diapazone në % të përcaktuara si më sipër nga ana e autoritetit tuaj kontraktor, si edhe vetë numri i lëndëve dhe tipi i lëndëve aktive në përbërje të produktëve biocide që kërkohen për realizimin e këtij tenderi; janë të paracaktuara dhe të përafërta me përbërjen e lëndëve aktive dhe përqëndrimeve të tyre në % si të specifikuar në përbërje të vetëm një produkti biocid. Ky diapazon i ngushtë i % të lëndëve aktive (lëndës aktive), është vendosur qëllimisht që të përfshijë vetëm përbërjen në % të lëndëve ose lëndës aktive në vetëm një produkt biocid, duke paracaktuar në këtë mënyrë edhe produktin biocid që do të përdoret. I vetmi ndryshim nga caktimi i emri konkret tregëtar të produktit biocid, është vendosja e kriterëve të tilla abuzive pra, produktin biocid nuk e përcakton me emrin e tij tregëtar (sepse kjo dukshëm nuk lejohet), por e paracakton me faktin e vendosjes së kriterëve të përbërjes së lëndës ose lëndëve aktive specifike të vetëm atij produkti, dhe me faktin e vendosjes së kriterit të



diapazonit tepër të ngushtë të përbërjes në % të lëndës ose lëndëve aktive të këtij produkti biocid. Në dukje nuk përcaktohet emri tregëtar, por vendosen përbërja e lëndëve aktive dhe % e lëndëve konkrete që referohen në produkt, që në fakt i ka dhe i plotëson vetëm një produkt apo në numër shumë i vogël produktesh në treg.

Kjo është në kundërshtim me ligjin, pasi është diskriminuose dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar.

4- Në lidhje me:..”PREPARAT PËR LUFTIMIN E FURRTAREVE. Insekticid për luftimin e insekteve në formë xheli. Lënda bazë aktive e këtij preparati duhet të jetë Imidacloprid (CAS no.138261-41-3) në përqëndrim 2%-2.5%. Preparati duhet të ketë në përbërjen e tij minimumi një lëndë konservuese për të garantuar jetëgjatësinë. Paketimi: Në konfeksion plastik në formë shiringe 10g-30g. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. ...”, i kundërshtojmë specifikimet teknike të mësipërme me argumentat si vijon:

Edhe në këtë rast qëndron i njënti arsyetim si më sipër. Përse vendoset vetëm një lëndë aktive në përbërje të xheleve të kërkuesit? Dhe përse vendoset vetëm ky lloj përqëndrimi kaq i ngushtë? Kërkojmë që të vendosen disa lëndë aktive piretroide etj, si edhe të mos vendoset përbërja në % e ketyre lëndëve, ose të shtohet fjalia “ose produktë ose lëndë aktive të ngjashme dhe ekuivalentë”, sikurse vetë ligji dhe rregullat e prokurimit publik kërkojnë, duke mundësuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë të cilët vepronë në këtë fushë, pra duke siguruar konkurrencën e ndershme dhe duke mos paracaktuar fituesin e procedurës së prokurimit.

5- Në lidhje me:..”PREPARAT PËR LUFTIMIN E MINJVE. Rodenticid për luftimin e minjve në mjedise të hapura dhe të mbylluara. Ky preparat duhet të jetë i tipit pellet, pastabël ose block. Lënda bazë aktive e rodenticidit duhet të jetë Coumatetralyl (CAS no. 5836-29-3) me përqëndrim 0.03%-0.04%. Për të evituar kontaktin rodenticidit me gjallesat e tjera përveç minjve dhe për t’i ruajtur nga agjentët atmosferikë duhet të jenë të veshuara me një shtresë e cila të jetë hidhëruese me anë të lëndëve aktive si Bitrex (denatonium benzoatë, CAS no. 3734-33-6) ose ekuivalentin e tij të destinuar për këtë qëllim. Paketimi: Në konfeksion plastik 0.1kg-5kg i ndarë në copa nga 10-15g secila. Jetëgjatësia: jo më pak se një vit nga data e lëvrimit. ...”, i kundërshtojmë specifikimet teknike të mësipërme me argumentat si vijon:

Edhe në rastin e rodenticideve, është vendosur vetëm një lëndë e vetme aktive, Coumatetralyl dhe diapazoni i ngushtë në përbërje të saj. Përse nuk vendosen edhe lëndë aktive si Bromadiolone, Difenacoum, Brodifacoum, ëarfarine etj? Këto kërkesa janë abuzive dhe diskriminuose dhe kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi

Në keto kushte rrjedhimisht mendojmë se, përmbajtja e lëndëve aktive për produktet e mësipërme në diapazone në % të përcaktuara si më sipër, nga ana e autoritetit tuaj kontraktor, si dhe vetë numri i lëndëve dhe tipi i lëndëve aktive në përbërje të produkteve biocid që kërkohen për realizimin e këtij tenderi, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit public të drejtojnë vetëm në një produkt biocid.

Ky diapazon i ngushtë i % të lëndës aktive, është vendosur qëllimisht se këtë përqindje e ka vetëm një produkt biocid, duke paracaktuar dhe paravendosur në këtë mënyrë edhe produktin biocid që do të përdoret, pra edhe fituesin e kësaj procedure prokurimi. Pra autoriteti kontraktor duke përcaktuar të tilla specifikime teknike vetëm emrin konkret tregëtar të produktit biocid nuk ka përcaktuar dhe kjo “teknikë/ metodë” është abuzive dhe e paligjshme sepse, produktin biocid nuk e përcakton me emrin e tij tregëtar (sepse kjo dukshëm nuk lejohet nga ligji), por e përcakton me faktin e vendosjes së kriterëve të përbërjes së lëndës ose lëndëve aktive specifike të vetëm atij

produkti, dhe me faktin e vendosjes se kriterit të diapazonit tepër të ngushtë të përbërjes në % të lëndës ose lëndëve aktive të këtij produkti biocid. Në dukje nuk përcaktohet emri tregëtar, por vendosen përbërja e lëndëve aktive dhe % e lëndëve konkrete që referohen në produkt, që në fakt i ka dhe i plotëson vetëm një produkt apo në numër shumë i vogël produktesh në treg.

Kjo është në kundërshtim me ligjin, pasi është diskriminuese dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të interesuar.

I kërkojmë Njësise suaj të prokurimit, që të konsultohen me ECHA dhe rregulloret e saj dhe të BE për produktet biocide në përdorim për shëndetin publik, përbërjen e lëndëve aktive të tyre, përqëndrimin e lejuar në përdorim në shendet publik dhe jo në bujqësi për mbrojtjen e bimeve apo në shërbimet veterinarë, sepse janë shumë të ndryshme me ato në përdorimin e shëndetit publik. Për gjithë sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e specifikimeve teknike të kundërshtuara nga ana jonë dhe hartimin e tyre në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, në përputhje me normat ndërkombëtare të përcaktuara në ECHA dhe të BE-së, për produktet biocide në përdorim për shëndetin publik, për përbërjen e lëndëve aktive të tyre, pasi specifikimet teknike të vendosura nga ana juaj janë në kundërshtim me nenin 36 (Specifikimet teknike) të LPP përcaktohet:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet?

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me ?do mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

Sic e argumentuam më sipër, produktet e kërkuara, përbërjet dhe % e kërkuara për lëndët active në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, janë vendosur të tilla që të çojnë në produkte konkrete të cilat prodhohen nga kompani të caktuara dhe që rrjedhimisht të drejtën e tregëtimit të tyre e kanë kompani të caktuara edhe pse, referuar shërbimeve të cilat kërkohen të realizohen nuk ka asnjë argument ligjot apo teknik që ta detyrojnë autoritetin kontraktor të përcaktojë të tilla specifikime teknike për produktet që duhet të përdoren. Për autoritetin kontraktor rëndësi ka realizimi i shërbimit me parametrat e kërkuar dhe jo përdorimi i produkteve specifike. Përcaktimi i specifikimeve të tilla teknike sjell për pasojë penalizimin e pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë të cilët edhe pse kane vite që operojnë në këtë fushë nuk mund të marrin pjesë sepse përdorin produkte të tjera të cilat edhe pse e realizojnë qëllimin e autoritetit kontraktor për shërbimin e kërkuar nuk janë fiks ato të kërkuara në mënyrë të paligjshme nga Autoriteti kontraktor.

Për më tepër, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e tij Nr. 640/2022 të datës 08.07.2022, mbi ankesën e dy operatorëve ekonomikë, të cilët janë ankuar për specifikimet teknike të për të njejëta produkte të kërkuara edhe në këtë procedure prokurimi, produkteve biocide ku përfshihet ekzaktësisht me të njëjtat specifikime teknike, procedure prokurimi e shpallur nga autoriteti kontraktor Universiteti i Tiranës, ka vendosur të pranojë pretendimet e këtyre operatorëve ekonomikë, duke urdhëruar autoritetin kontraktor të ndryshojë specififikimet teknike të produkteve e konkretisht KPP ka arsyetuar:

“Në rastin konkret, referuar objektit të prokurimit dhe Shtojcës 5

“Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi pasi nga ana e autoritetit kontraktor është plotësuar kjo shtojcë me përshkrimet konkrete të preparateve, KPP gjykon, se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme, që të përcaktojë se produktet që do të përdoren për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi duhet t’i përkasin grupit të produkteve biocide duke përfshirë insekticide dhe rodenticide që luftojnë sipas rastit (viruset, bakteret, kërpudhat, mykun, insekticidet për luftimin e insekteve, zvarritësit dhe minjtë) çka është dhe qëllimi për të cilën kryhet kjo procedurë prokurimi, sipas parashikimeve të VKM Nr. 487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, por duke mos përcaktuar emrin e produktit konkret apo duke vendosur lëndën aktive konkrete pa ekuivalentin e saj, pasi në VKM nr. 933, datë 24.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” janë disa produkte me emërtime të ndryshme që i përkasin kategorisë së produkteve biocide që luftojnë viruset, insektet dhe minjtë dhe që mund të përmbajnë jo vetëm lëndët aktive të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, por edhe ekuivalentet e tyre që kryejnë të njëjtin funksion dhe që prodhohen nga prodhues të ndryshëm. Gjithashtu, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor nuk ka arritur të argumentojë teknikisht në specifikime teknike, se pse duhet të përdoren ato lëndë aktive në secilin prej preparateve të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe pse janë pikërisht ato të vetmet lëndë aktive të kombinuara që luftojnë viruset, bakteret, kërpudhat, mykun, insektet dhe zvarritësit, si dhe minjtë dhe se asnjë nga produktet e tjera biocide të parashikuara në VKM nr. 933, datë 21.11.2020, nuk e realizon këtë funksion. Për sa më sipër Komisioni Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa në lidhje me kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike, duke ndryshuar specififikimet lidhur me lëndët aktive të preparateve, duke vendosur edhe termin “ose ekuivalente” për secilën prej tyre, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen

dhe konkurrencën, si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

?.. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Murati BA” SHPK, mbi diapazonin e përqendrimit të lëndëve aktive të preparateve, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit si dhe ka detyrë të përcaktojë kritere dhe specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere dhe specifikime teknike në lidhje me shërbimin e kërkuar, por pa përcaktuar kritere apo specifikime të cilat mund të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në cilësinë e shërbimit, pasi përcaktime të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë e operatorëve ekonomikë të interesuar. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimesit lidhur me diapazonin e përqendrimit të lëndëve aktive të preparateve, si dhe kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, ky i fundit në asnjë moment nuk ka argumentuar se si ndikon zgjerimi i diapazonit të përqendrimit të lëndëve aktive të preparative të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe çfarë pasojash sjell në ofrimin e shërbimit apo në sigurinë mjedisore modifikimi i këtij diapazoni, duke mos dhënë një shpjegim të natyrës teknike, por një shpjegim narrativ si “Përcaktimi i diapazonit të lëndëve biocide është i përcaktuar duke ruajtur impaktin në mjedis pa cenuar efektshmërinë e tyre”. Në këtë kuadër Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për zgjerimin e diapazonit të përqendrimit të lëndëve aktive të preparateve, që ka përcaktuar në specifikimet teknike, në mënyrë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën, si dhe të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik “Murati BA” SHPK qëndron?”

Pra në përfundim, me qëllim rritjen e konkurrencës, eliminimin e pengesave të paligjshme për të ofertuar, shmangien e favorizimeve të padrejta ndaj ndonjë operatorit të caktuar dhe me qëllim realizimin e procedurës në përputhje me rregullat e prokurimit publik kërkojmë, të ndryshohen specifikimet teknike duke zgjeruar gamën e produkteve të cilat do të përdoren dhe në çdo rast në dokumentat e tenderit për produktet të vendoset por edhe fraza: “SI EDHE CDO PRODUKT TJETER I NGJASHEM / ALTERNATIV OSE EKULALENT ME TE”

II. Në lidhje me kriterin për kualifikim të vendosur në dokumentat e tenderit në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek germa a) e pikës 2, në të cilin kërkohet për Drejtuesin Teknik si vijon: “...Ne zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklaratë perkatese.”, kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë pasi nuk është në përputhje me objektin e prokurimit dhe kufizon konkurrencën dhe pengon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi në mënyrë të paligjshme.

Kërkesat dhe kushtet që duhet të plotësojë një person për tu përcaktuar si drejtues teknik i shoqërive meobjekt veprimtarie në Fushën e DDD janë të përcaktuara në mënyrë të qartë në legjislacionin specifik i cili rregullon këtë fushë e konkretisht:

- Bazuar në legjislacionin e fushës përkatëse, konkretisht VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës Kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera Nënligjore të përbashkëta”, pika c e Dispozitave të Përgjithshme, përcaktohet termi “Drejtues teknik” - funksioni/ne që kanë përgjegjësinë teknike

profesionale, në emër të subjektit që licencohet/lejohe, e që sipas sferës konkrete të veprimtarisë, mund të marrë emërtime të veçanta rast për rast”. Ndërkohë në Aneksin 1 të vendimit të mësipërm, ligjvënësi ka parashikuar: “Kategoritë e licencave e lejeve që si rregull trajtohen nga ose nëpërmjet qkl-së”, ku konstatohet se; “Veprimtaritë që kryejnë “shërbime të tjera shëndetësore ose higjiëno-sanitare” janë ato të përcaktuara në kategorinë II.8 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Veprimtaritë e kësaj kategorie ndahen në dy nënkategori si vijon: a) “shërbime ekspertize higjiëno-shëndetësore” me kodin II.8.A; dhe b)“shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore” të tilla dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera të këtij lloji me kodin II.8.B.

- Pra sa më sipër, çdo subjekt i cili kryen një nga veprimtaritë e mësipërme duhet të pajiset me licencën përkatëse. Referuar dispozitave të mësipërme, konkretisht pikës 5, konstatohet se në kriteret e posaçme të licencimit, se mbi çfarë faktorësh veprimtarie dhe/ose specifikash e specialitetesh aplikohen kriteret e posaçme, si dhe llojet e dokumenteve provuese e shoqëruese përkatëse për nënkategorinë A, B, C të veprimtarisë, si dokumente provuese lidhur me kriteret e posaçme për pajisjen me licencë, kërkohet që drejtuesi teknik duhet të ketë njohuri të përshtatshme dhe eksperiencë për kryerjen e detyrës së drejtuesit teknik, por ndërkohë nga ana tjetër nuk specifikohet se për drejtuesit teknik të licencës së kategorisë II.8.B nuk parashikohet si kriter i posaçëm që ky drejtues teknik të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë subjektit tregtar mbajtës i kësaj tipi licence. Pra, shoqëritë të cilat kryejnë veprimtari shërbime ndërhyrëse higjiëno-shëndetësore të tilla si dezinfektimi, deratizimi, dizensektimi dhe të tjera, duhet të pajisjen me licencë përkatëse duke plotësuar disa kushte specifike, ku ndër të tjera kërkohet disponimi i një drejtuesi teknik të pajisur me certifikatë dhe kontratë pune. Edhe në ligjin specifik të fushës, konkretisht Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” në nenin 9 pika 2/a të tij “Vendosja në treg e produkteve biocide”, përcaktohet shprehimisht se 2. “Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme: a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik”. Pra, ligjvënësi ka parashikuar si kusht të domosdoshëm për kryerjen e veprimtarisë objekt prokurimi, disponimin nga shoqëria të një drejtuesi teknik, për këtë arsye, në rastin konkret operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi, janë në të drejtën e tyre të disponojnë vetëm një drejtues teknik sipas të gjitha kërkesave ligjore, por nuk mund të kufizojnë veprimtarinë e tyre, në punësimin me kohë të plotë vetëm në një kompani, pasi kjo do të ishte diskriminuese për to, për sa kohe ligji I posacem nuk e ka përcaktuar një detyrim të tillë. Sa më sipër, gjykojmë se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me paraqitjen e deklaratës se, drejtuesi teknik nuk është i dy punësuar në sektor privat apo publik. gjatë periudhës së realizimit të objektit, është një kriter diskriminues i cili kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë, për sa kohë këta që legjislacioni I fushës nuk kërkon angazhimin detyrimisht me kohë të plote të drejtuesit teknik në kompaninë në të cilën është vendosur si drejtues Teknik.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e tij Nr. 628/2022, datë 04.07.2022 dhe për më tepër në procesverbalin e hartimit të dokumenteve të tenderit nuk ka asnjë argument teknik apo ligjor për se është e rëndësishme për objektin e prokurimit që drejtuesi teknik i shoqërisë nuk duhet të jetë i dypunësuar.

Në përfundim, kërkojmë, heqjen e kriterit që: ”Në zbatim të akteve ligjore, drejtuesi i mesipërm nuk duhet të figurojë i dy punësuar në sektor privat apo publik. Për këtë Administratori/ Drejtuesi Ligjor i shoqërisë të paraqes deklaratë përkatëse.”, pasi nuk është kriter i cili lidhet ngushtë me objektin e prokurimit, është i ekzagjeruar, i paargumentuar dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve

ekonomik.

III. Kundërshtojmë kriterin për kualifikim të vendosur në dokumentat e tenderit në Shtojcën 8të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek germa b) të pikës 2, në të cilin është kërkuar: "Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar staf si me poshte:...

b) Minimalisht 2 (dy) persona, sipas profileve të mëposhtme:

- specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren;

- .....

- Per punonjesit e percaktuar ne piken b) të paraqiten certifikata/dëshmi trajnimi të vlefshme për operimin e pajisjeve dhe/ose preparateve, si dhe kontrata pune..." me argumentat si vijon:

- Kërkesat për të pasur në stafin e vetë e OE-së 2 (dy) punonjës të kualifikuar dhe trajnuar në fushën e DDD është e ligjshme dhe është në të drejtën e autoritetit kontraktor për tu garantuar që kompania që do të realizojë shërbimin DDD ka stafin e nevojshëm dhe të kualifikuar për ta kryer atë në përputhje me rregullat e kësaj fushe. Për këtë pjesë nuk kemi asnjë kundërshtim por, ajo që ne kundërshtojmë është profili i kërkuar nga AK-ja si: "specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren", ky profil nuk figurojnë as në legjislacionin spicifik të fushës dhe as në VKM 514 datë 20.09.20117 "Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve LKP, te rishikuar".

Profili "specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese dhe për të cilin duhet të paraqiten certifikata respektive me këtë emërtim nuk figurojnë ne VKM 514 datë 20.09.20117 "Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve LKP, te rishikuar, për pasojë është kërkesë e cila penalizon opertorët e konomike ne mënyrë të paligjshme, kufizojnë pjesmarrjen e tyre për pasojë janë në kundërshtim me nenin 77 të LPP-së në të cilin përcaktohet si vijon:

"Neni 77 (Kërkesat për kualifikim)

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës."

Në procesverbalin e hartimit të dokumentave autoriteti kontraktor nuk jep asnjë argument përse është e nevojshme të jenë në stafin e operatorit ekonomik pikërisht ky lloj profili me këtë certifikim. Pse pikërisht këto certifikime?

Kjo kërkesë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit pasi, për të realizuar shërbimet e përcatuara në dokumentat e tenderit, punonjësit e emërtuar nga autoriteti kontraktor si: "specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese..." (që në vlerësimin tonë është kërkuar vetëm sepse ndonjë operator i cili është i preferuar i Autoritetit kontraktor duhet ta ketë) nuk është e nevojshme për të realizuar objektin e prokurimit për asyet si më poshtë:

Sikurse jeni në dijeni, në VKM 514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e Listës Kombëtare të

Profesioneve LKP, te rishikuar” janë përcaktuar kodet e punësimit për të gjitha profesionet. Referuar kësaj VKM- je, në faqen 800 të saj, është përcaktuar me kod profesioni “7544” kategoria e “Kontrollorëve të dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte dhe barëra të këqinj”, për të cilët janë përcaktuar funksionet si më poshtë vijon:

” Përshkrim i përgjithshëm i grupit të profesioneve “Kontrollorë të dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte, barëra të këqinj”, niveli i dytë i kompetencës në LKP.

Kontrollori i dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte e barëra të këqij përdor kimikate për të eliminuar insektet e dëmshme, brejtës të vegjël, bimë të egra dhe organizma të tjera të dëmshme për të parandaluar dëmtimin e kulturave dhe të ndërtesave si dhe strukturave të tjera së bashku me rrethinat e tyre, për të parandaluar rreziqet ndaj shëndetit.

Funksionet kryesore Kontrollorët e dezinfektimit të mjedisit për baktere, insekte, barëra të këqij kryejnë një pjesë apo tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:

- a) Inspektojnë objektet për të identifikuar burimin e infektimi dhe shkallën e dëmtimit të pronës, porozitetin e mureve dhe të çatave dhe ndikimin e tyre nga vende të infektuara;
- b) Studiojnë zonat e infektuara dhe përcaktojnë llojin e trajtimit të kërkuar për të eliminuar dhe parandaluar përsëritjen e infektimit;
- c) Punojnë dhe monitorojnë pajisjet për spërkatje dëmtuesit dhe barërat e këqija;
- d) Trajtojnë, përziejnë dhe depozitojnë kimikatet duke ndjekur udhëzimet për masat e sigurisë të përcaktuara nga prodhuesit dhe legjislacioni në fuqi;
- e) Trajtojnë ndërtesa me pesticide zonat në thellësi të caktuara, duke aplikuar njohuritë e kushteve të motit, madhësinë e pikimeve, raportet lartësi-distancë dhe pengesat e mundshme;
- f) Spërkatin apo shpërndajnë solucione kimike, pluhura apo gazra toksike në ambiente dhomash, në veshje, orendi shtëpiake apo punime druri si dhe mbi kënetat, kanalet e ujërave të zeza dhe të baseneve ujore;
- g) Vendosin çarqe mekanike për të eliminuar dëmtues dhe parazitë të tillë si minj, termite dhe brumbuj;
- h) Vendosin pastë apo ushqim tërheqës helmues në kanalizimet e ujërave të zeza, strofka dhe kanale të hapur të ndotur;
- i) Ngrenë, shtyjnë dhe lëvizin tubat elastike prej gome në mënyrë që të spërkasin direkt mbi zona të caktuara;
- j) Vendosin në punë gjeneratorë, kompresorë dhe pompat manuale apo elektrike për të injektuar ose spërkatur pesticidet dhe herbicidet e lëngëta dhe të gazta;
- k) Mbushin pajisjet spërkatës me ujë dhe kimikate;
- l) Kujdesen për të minimizuar dëmtimin në bimë të tjera, në kafshët dhe në mjedisin përreth;
- m) Pastrojnë dhe i bëjnë shërbime pajisjeve për të siguruar efikasitetin e duhur;
- n) Mbajnë pajisje në mënyrë efikase dhe në radhë të sigurt pune;
- o) Këshillojnë njerëzit për masat parandaluese dhe shkruajnë raporte informimi për klientët;
- p) Kryejnë punime të tjera të ngjashme si këto;
- q) Zbatojnë rregullat në mbrojtje të mjedisit dhe shëndetit të njerëzve;
- r) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës...”.

Pra, në këtë VKM në vijim janë përshkruar edhe Funksionet kryesore që kryejnë këta punonjës. Në nëkategoritë e e këtij grupi njësi nuk figurojnë profesionet e cituara nga AK-ja si ”specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese...” pasi të gjitha detyrat për realizimin e shërbimit të dezinfektimit i realizojnë punonjësit e emërtuar “Dezinfektues të mjedisit, për baktere, insekte, barëra të këqinj”, të cilët gjithashtu njohin operimin e pajisjeve dhe mjeteve duke përfshirë konstruksionin e tyre, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Ligji posacëm kërkon që kompania të jetë e licensuar, licensë e cila është kërkuar nga ana juaj.

Në Vendimin Nr. 637/2022, datë 06.07.2022, Komisioni i Prokurimit Public arsyeton: “? Në këto kushte, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për pajisjen me certifikime të punonjësve, është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përpjesëtim me proceset e punës që parashikohen dhe volumin e kontratës që prokurohet, ndërsa për sa i përket profilit të certifikimit të kërkuar, autoriteti kontraktor këto përcaktime duhet t’i bëjë në përputhje me VKM 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”. Ndaj KPP thekson, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri në lidhje me përcaktimin e profilit të certifikimeve sipas parashikimeve ligjore të sipërcituara. Referuar testit të proporcionalitetit, vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale (stafin), në përputhje dhe në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt-prokurimi. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin, se duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse, si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik dhe legjislacionit të posaçëm.

- Për gjithë sa më sipër në përfundim, kërkojmë, ndryshimin e kriterit të përcaktuar në gjurmën 2/b) të pikës 2.3 (kapaciteti teknik) në shtojcën 8 të dokumentave të tenderit duke hequr kërkesën për “specialist për operimin e pajisjeve dezinfektuese sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren” dhe të certifikatës repektive dhe kërkojmë vendosjen e e kësaj kërkesë në përputhje me profilet e përcaktura për këtë fushë në VKM 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve LKP, të rishikuar”.

IV. Kundërshtojmë pjesërisht kriterin për kualifikim të vendosur në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 5, në të cilin është kërkuar:

“..Operatorët ekonomike me ane të një deklaratë, duhet të marrin persiper, se me nënshkrimin e kontratës, duhet të paraqes për çdo produkt, raport-testimet si dhe certifikimet perkatese, të cilat duhet të jene sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike të AK, të leshuara nga organet kompetente të akredituara.” me argumentat si vijon:

Konkretisht në kriterin e mësipërm kundërshtojmë kërkesën e AK-së që me nënshkrimin e kontratës, operatori ekonomik duhet të paraqesë për çdo produkt edhe raport-testimet, të cilat duhet të jene sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike të AK, të leshuara nga organet kompetente të akredituara.

Sic kemi shpjeguar dhe arsyetuar edhe më sipër për produktet biocide kanë një legjislacion të posaçëm i cili rregullon, importimin e tyre, marrjen e lejeve për tregëtim nga strukturat përkatëse shtetërore, ku përcaktohet edhe lista e dokumentacionit teknik dhe ligjor që duhet të disponojnë kompanitë cilat duan të importojnë apo tregëtojnë në tregun shqiptar këto produkte biocide.

Kërkohet të deklarohej se produktet biocide do të shoqërohen me raport testimi nga organet kompetente të ndërkohë që, në Shqipëri, jo vetëm që nuk ka asnjë organ të akredituar për kryerjen e testimeve për produktet biocide/produktet me të cilat kërkohet të kryhet ky shërbim (mjafton të verifikosh organet e akredituara në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit [dpa.gov.al](http://dpa.gov.al), ku nuk rezulton asnjë laborator i akredituar për të kryer analiza të produkteve biocide),



por për më tepër kjo kërkesë është e panevojshme sepse blerja e mallit nga subjektet të cilat ofrojnë shërbimin për këtë objekt-prokurimi, ka një rregullim të posaçëm ligjor dhe kryhet sipas disa procedurave specifike, duke u shoqëruar me dokumentacion përkatës, për vendosjen e tyre në treg (Ligji 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij). Kontraktor. Sa më sipër, referuar Ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe rregullat në zbatim të tij, produktet për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, pajisen me dokumentacion përkatës për vendosjen e tyre në treg në Republikën e Shqipërisë dhe duke qenë se për këtë procedurë ka një rregullim specifik, autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë për këto produkte dokumentacion shoqëruar të ndryshëm nga sa parashikon ligji i posaçëm, pasi në këtë mënyrë krijon konfuzion dhe paqartësi tek operatorët ekonomikë të cilët kërkojnë të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin e tij Nr. 628/2022, datë 04.07.2022.

Sa më sipër, kërkojmë, ndryshimin e kriterit për kualifikim të vendosur në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 5, duke hequr kërkesën që, me nënshkrimin e kontrates, operatori ekonomik duhet të paraqesë për çdo produkt edhe raport-testimet, të cilat duhet të jenë sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike të AK, të leshuara nga organet kompetente të akredituara.

V. Kërkojmë modifikimin e kriterit për kualifikim të vendosur në Shtojcën 8 të DT, tek 2.3 (kapaciteti teknik) tek pika 7, në të cilin është kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se, produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, janë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.” me argumentet si më poshtë:

Jo të gjitha produktet e përcaktuara nga ana juaj për realizimin e këtij shërbimi janë biocide të cilat përdoren në shëndet public dhe për pasojë të jenë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në rastin konkret Preparat për dezinfektim, Biocid dizinfektant me spektër të veprimit kundër viruseve, baktereve, kërpudhave, mykut etj. Është një Viroid i cili nuk është i lejuar për përdorim në shëndet public dhe për pasojë nuk mund të jetë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pasi autorizimi për tregëtim për këtë produkt jepet nga Ministria e Bujqësisë dhe jo nga Ministria i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për sa më sipër, kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke e kërkuar këtë deklaratë vetëm për produktet biocide të cilat janë për përdorim në shëndetin public, pra për të cilat është detyrimi për të qenë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të kundërt deklarimi ynë do të ishte i pasaktë ose mund të vlerësohej se do të ishte në kushtet e një deklarimi të rreme.

Në përfundim, të nderuar zyrtarë të autoritetit kontraktor, pavarësisht sa më sipër, mbetemi me shpresë se, pretendimet dhe ankesat e paraqitura në këtë formular ankese do të pranohen nga ana juaj dhe vendimarrja juaj do të jetë në përputhje me rregullat dhe parimet e ligjislacionit publik.

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme □

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonte)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

jo

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

jo

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

egianmed@gmail.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Fatos Lashi